

Qyteti Vantaa
Enti i arsimit dhe edukimit
Edukimi i hershëm
6.5.2020

Të dashur prindër të fëmijëve në edukimin e hershëm,

Sipas rekomandimeve më të reja të Qeverisë finlandeze bazuar në ligjin për mësimin fillor dhe në ligjin për edukimin e hershëm kthimi në mësimin dhe edukimin e hershëm bëhet duke filluar nga 14. maji në masë të kontrolluar dhe gradualisht. Njësitë e edukimit të hershëm kanë qenë të hapura edhe deri tani, por ka pasur sugjerime të forta që fëmijët të qëndrojnë në shtëpi për kujdesje. Kufizimet për qerdhet e fëmijëve largohen dhe fëmijët mund të kthehen në edukimin e hershëm. Zyrtarët shëndetsor kanë dëshmuar, se fëmijët janë të sigurt të kthehen në edukimin e hershëm.

Njëkohësisht nga ana e pagesave si klient në edukimin e hershëm kompezimi për pagesat e tepërta për shkak të mungesave të fëmijëve përfundon më 13.5.2020. Pranimi i garancionit për të siguruar vendin për edukimin e hershëm komunal kthehet në praktikën normale pas së paku 2 muaj ndërprerje.

Të gjitha qerdhet e edukimit të hershëm dhe qerdhet për grupet familjare hapen duke filluar nga 14.5.2020. Kjo nuk vlen për qerdhet që me ligj është e rregulluar të jenë të hapura, për parqet me pjesëmarrje familjare dhe klubet që vazhdojnë të jenë ende të mbyllura.

Mësimi parashkollor nuk organizohet më nga distanca duke filluar nga 14.5. Fëmija duhet të vijë në mësimin parashkollor. Për mungesa duhet kërkuar leje. Drejtuesi i qerdhes e analizon, se a ka bazë për të dhënë leje. Për shembull për sëmundje apo nëse nxënësi ose ndonjë antar i familjes bënë pjesë në grupin me rrezikshmëri të infektimit kjo do të ishte arsye që pranohet për të munguar.

Grupet e fëmijëve në qerdhe mbahen mundësisht sa më të vogla ndërsa veprimtaria ditore në edukimin e hershëm mbahet në grupe më të vogla se normalisht. Në këto veprimtari do të shfrytëzohen të gjitha hapësirat që janë në përdorim brenda dhe jashtë qerdhes, ashtuqë fëmijët dhe të rriturit mundësisht të kenë sa më shumë largësi mes veti. Gjatë kohës së ditës fëmijët shkojnë jashtë në masë të mirë e në grupe të vogla me intervale dhe kohë të ndryshme. Ardhjen e fëmijëve në qerdhe dhe largimin për në shtëpi e organizojmë ashtu, që prindërit nuk vijnë brenda në qerdhe dhe kështu i mbajmë largësit fizike mes veti. Në qerdhe nuk lejohet sjellja e lodrave të veta. Ngrënja e ushqimit poashtu organizohet në grupe të vogla. Gjatë kohës së ditës i praktikojmë udhëzimet efektive të higjenës, teshtijmë në mëngë, i pastrojmë duart gjithnjë kur vijmë brenda, para ngrënjes së ushqimit dhe gjithnjë gjatë përdorimit të WC-së si dhe pas kthimit në shtëpi. Pavarësisht mbajtjes perfekte të higjenës, kujdesemi që fëmija të ketë afërsin e duhur me prindin, sigurin dhe komunikimin mundësisht në mënyrën e njejtë sikurse më herët.

Sipas udhëzimeve të Institutit të shëndetit dhe mirëqenjes, fëmija duhet të qëndroj në shtëpi, nëse ai ka edhe simptoma të lehta të gripit. Fëmija mund të kthehet në qerdhe, pasi që të ketë qenë pa simptoma një ditë dhe një natë. Fëmija që është i infektuar me koronavirusin duhet të qëndroj jashtë mësimin në edukimin e hershëm së paku shatë ditë dhe shtatë netë nga koha kur kanë filluar

simptomat, por nëse duhet edhe më gjatë ashtu, që ai të jetë së paku dy ditë dhe dy netë pa simptoma para se të kthehet në mësimin e hershëm. Për fëmijët që j'u takojnë grupit me rrezikshmëri të infektimit vlerësimi shëndetsor për pjesëmarrjen e tij duhet të bëhet nga një vlerësim i bërë nga trajtimi mjeksor. Mjeku që e kontrollon e vlerëson se a mundet fëmija, i cili ka sëmundje apo një antar tjetër i familjes ka një sëmundje të vështirë apo që ka nevojë për terapi të rregullt për aftësin mbrojtëse nga paraliza, të kthehet në mësimin për edukimin e hershëm. Grupit me rrezikshmëri për sëmundje të vështirë me koronavirusin ju takojnë ata fëmijë, të cilët për ndryshe kanë sëmundje tjera si mundësi e zgjeruar e rrezikut serioz si pasojë e infektimit.

Jemi të lumtur lidhur me ate, që përsëri mund të fillojmë të pranojmë fëmijët në edukimin e hershëm. Për të rezervuar personel të mjaftueshëm kërkojmë nga ju prindërit që menjëherë të lajmëroni për përkujdesjen që ju nevojitet në edukimin e hershëm gjatë kohës 14.5. – 31.5. përmes telefoni, postës elektronike apo me një mënyrë tjetër të marrëveshjes me vendin e edukimit të hershëm. Kjo na e lehtëson përgatitjen tonë me personelin, organizimin e shërbimit të ushqimit dhe të pastrimit. Ndjejmë keqardhje, nëse ju shqetësojmë me këtë orarë të shpejtuar, meqë nuk kemi kërkuar nga ju të lajmëroni për nevojat për përkujdesje gjatë kohës së verës.

Më tepër informata ju dhënë drejtuesit e qerdheve të vendit tuaj për edukimin e hershëm. Prej tyre mund të pyetni të dhëna shtesë për organizimin e veprimtarisë dhe gjithëçka që ju mundon rreth kthimit të fëmijëve në edukimin e hershëm.

Përshëndetje miqësore

Sole Askola-Vehviläinen
drejtuese e edukimit në fëmijërinë e herëshme